Shtojca 7: Formularët e Përshtatshmërisë dhe Kualifikimit të Ofertuesve

Shtojca 8: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 9: Formulari i Vlerësimit

Shtojca 10: Preventivat e Punimeve

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.

Shtojca 12 - Formulari i Njoftimit të Fituesit

Shtojca 13 Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit) .

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Pas procesit të ankimit)

**Shtojca 1.**

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

**FORMULARI I OFERTËS**

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'ë realizojmë për Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), punimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në preventiv, me të gjitha projektet teknike, e me kërkesat në detyrën e projektimit apo termat e referencës, nëse është rasti, dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
  1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  2. Njoftimin e Kontrates;
  3. Kriteret e Vlerësimit;
  4. Kriteret e Përzgjedhjes;
  5. Specifikimet teknike, Projektet dhe çdo dokumentacion teknik;
  6. Preventivin e çmimeve
  7. Termat e referencës (nëse është rasti)
  8. Detyrën e projektimit (nëse është rasti)
  9. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  10. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë]

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	

**Shtojca 2.***(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** \_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

**Oferta ekonomike e detajuar**

Nr	Nr. Analizë	Përshkrimi i Punëve	Njësi	Sasia	Çmimi/ Njësi	Cmimi total
1.						
2.						
3.						
<b>Shuma</b>						
<b>Fondi Rezervë</b>						
<b>Shuma</b>						
<b>TVSH</b>						
<b>SHUMA TOTAL</b>						

**Nënshkrimi i ofertuesit** \_\_\_\_\_**Vula****Shënim:** Çmimet duhet të shprehen në Monedhën \_\_\_\_ ( e kërkuar në dokumentat e tenderit )



**Shtojca 3.**

[ *Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik* )

[ *Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve* ]

**FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS**

Për: [ *Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor* ]

Në emër të: [ *Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar* ]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [ *lloji i procedurës* ]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [ *objekti* ]

Publikimi ( *nëse zbatohet* ): Buletini i Njoftimeve Publike [ *Data* ] [ *Numri* ] / Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

*Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.*

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [ *emri i autoritetit /entit kontraktor* ] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [ *njoftimin e kontratës* ].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

**Shtojca 4.**

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

**Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

**VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Përfaqësuesi i Ofertuesit****Nënshkrimi****Vula**

## Shtojca 5.

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor* ]

### **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

**Të dhënat teknike të punëve objekt prokurimi duhet** të përshkruhen sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

SHËNIM: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Skicimet, parametrat teknik etj: **Bashkengjitur DST ne SPE.**

Specifikimi i Materialeve: **Bashkengjitur DST ne SPE.**

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: **Bashkengjitur DST ne SPE.**

**Shtojca 6**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

**GRAFIKUT I ZBATIMIT TË PUNIMEVE**

**Afatet e realizimit të punimeve:**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3. Afati i realizimit</i>				
<b>Nr</b>	<b>Përshkrimi i Punëve</b>	<b>Java 1/Muaji 1</b>	<b>Java 2/Muaji 2</b>	<b>Java 3/Muaji 3</b>	<b>Java 4/Muaji 4</b>	<b>Java 5/Muaji 5</b>
1.						
2.						
3.						
4						

Shënim. Autoriteti/enti kontraktor mund të shtojë rreshta në varësi të zërave të punimeve dhe kollona në varësi të afatit të parashikuar për realizimin e tyre.

**Bashkengjitur DST ne SPE.**

## Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojces 8.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **1. Kandidati/Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;*

c. *Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

#### **2.1. Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:**

Sipas percaktimeve te bera ne Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit).Kjo pikë plotësohet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

#### **2.2. Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare, **2019,2020 dhe 2021**,ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontrates pasi proceduar eshte ndermjete kufirit te larte dhe te ulet monetar. .

**2.2.2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2019,2020 dhe 2021**, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e percaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “ Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**2.2.3** Një dokument lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore që vërteton se subjekti i ka plotësuar detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2022 sipas kesteve te maturuara , referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, si dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin per te gjitha vendet

ku ushtron aktivitet sipas ekstratit te QKR. (në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

*Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetë deklarimit sipas shtojcës 8 në DST.*

### **2.3.Kapaciteti teknik:**

**2.3.1.Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:**

#### **Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme**

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogarit të kontratës që prokurohet , konkretisht në vlerën 22 562 837.5 ( njëzet e dy million e pesëqind e gjashtedhjetë e dy mijë e teteqind e tridhjetë e shtatë pike pese ) lek pa tvsh dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, konkretisht 90 251 350 lek(nentedhjetë million e dyqind e pesëdhjetë e një mijë e treqind e pesëdhjetë lek) pa tvsh..

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

- a) Si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkojmë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

#### **Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:**

Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar;
- Fatura tatimore,
- Aktin e kolaudimit; *(në rastet kur ky dokumentacion lëshohet)*
- Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme/perfundimtare të marrjes në dorezim.

**Shënim:***Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, kërkojmë si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Vertetim leshuar nga subjekti privat shoqëruar me:
  - Kontrate Sipërmarrje;
  - Situacionin përfundimtar;
  - Fatura tatimore,
  - Akt kolaudim i objekti; (***në rastet kur ky dokumentacion lëshohet***)
- Shënim:** Vertetimi duhet të percaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- Kontraten e bashkimit të operatoreve dhe prokuren e posacme të deklaruar në fazën e tenderimit;
- Per kontratat e realizuara si Nenkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:
  - a) Kontratë baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe
  - b) Miratimin zyrtar si nenkontraktor nga ana e Autoritetit Kontraktor.

**Pika 2.3.1 germa a)** plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.. Në rastin kur operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të permbushë këtë kusht.

**Kurse pika 2.3.1 germa /b** duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit **në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim**. (Neni 88, pika 3, i VKM-se nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik”).

**2.3.2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të leshuar nga Ministria e Infrastruktursë dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, “Per miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

#### ***PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI***

- NP-1A Punime gërmimi në tokë
- NP-2 A Ndërtime civile dhe industriale
- NP-3 A Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada
- NP-12 A Punime të inxhinierisë së mjedisit

#### ***PUNIME SPECIALE NDERTIMI***

- NS -1 A Punime për prishjen e ndërtimeve
- NS-2 A Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre
- NS-4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese



- NS-8 A Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri
- NS-12 A Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit
- NS-14 A Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktues dhe Energjise, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). **Mosparaqitja në këto forme është kusht skualifikues.**

**2.3.4** - Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht **57 persona**. Si dëshmi për fuqinë punëtore do të dorëzohen dokumentet si më poshtë;

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **maj –korrik 2022**,
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **maj –korrik 2022**,

**2.3.5**-Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë**, si më poshtë:

- 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi, profile strukturist
- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (nje) Arkitekt

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

*Për secilin pjestar të stafit teknik të mesiperm duhet të paraqesë, Kontrate pune e vlefshme, diplome , (Drejtuesit teknik të jone të siguruar sipas legjislacionit në fuqi për periudhën **maj- korrik 2022***

**2.3.6**.Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- - 1 (një) Inxhinier Mjedisi
- 1 (një) Inxhinier Mekanik

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

*Për secilin pjestar të stafit teknik të mesiperm duhet të paraqesë, Kontrate pune e vlefshme dhe diplome , (Stafi mbështetës të jone të siguruar sipas legjislacionit në fuqi për periudhën **maj- korrik 2022**.*

**2.3.7** Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar/ kualifikuar si më poshtë:

- Operatorët ekonomik të kenë në stafin e tyre **1 (një)** punonjës të pajisur me certifikatë “Koordinator për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M-së Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Për këtë duhet të paraqitet certifikata e trajnimit për Koordinator për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit për punë”, e dhënë nga një organizem i licënsuar, shqiptar ose i huaj, kontratën e punës të vlefshme dhe të figuroj në listëpagesat e shoqërisë për periudhën maj –korrik 2022..

**2.3.8**- Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, në ndërtimi dhe të deklarojë

se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtëm: diplome, libreze pune dhe kontrate pune te vlefshme.

Deklarata e administratorit te shoqerohet edhe me dhenien e nje deklarate personale nga vete drejtuesi teknik i OE.

**2.3.9- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar** punonjes specialistë të kualifikuar ne profilet perkatese si më poshtë:

- Elektracist 2 (dy)
- Hidraulik 2 (dy)
- Karpentiere 3 (tre)
- Hekurthyes 2 (dy)
- Saldator 1(nje)
- Mekanik 1 (nje)
- Murator 2(dy)
- Pllakashtrues 4(kater)
- Hidroizolues 3 (tre)
- Bojaxhi 4 (kater)
- Punetor/Specialist ndertimi 2 (dy)
- Manovrator 2(dy)
- Punonjës/specialist duralumini 1 (nje)
- Punonjës/specialist sistem ngrohje 3 (tre)

-Per punonjesit te paraqitet Kontrate pune e vlefshme, certifikatat perkatese si edhe te figurojne ne listepagesat e shoqerise. *për periudhën maj- korrik 2022.*

-Për manovratorët të paraqitet kontrata e punes dhe dëshmia e aftësisë profesionale lëshuar nga DPSHTRR . **(Në rastin kur punonjësit e mësipërm janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).**

-Operatori ekonomik duhet te kete 1 (nje) Teknik Ndertimi te cilet duhet te jene te pajisur me Kontrate pune te rregullt, diplome perkatese/deshmi kualifikimi, certifikate sigurimi teknik si dhe te figurojne ne listpagesen e shoqerise *për periudhën maj- korrik 2022..*

-Operatori ekonomik duhet te kete 1 (nje) Teknik Topograf te cilet duhet te jene te pajisur me Kontrate pune te rregullt, diplome perkatese/deshmi kualifikimi, certifikate sigurimi teknik si dhe te figurojne ne listpagesen e shoqerise *për periudhën maj- korrik 2022..*

- Operatori ekonomik te kete ne stafin e tij 2 (dy) specialist te certifikuar per "Punime ne lartesi", te cilet duhet te figurojne ne listepagesat e shoqerise per periudhen **maj- korrik 2022.**

Detyrimisht te paraqitet kontrate pune dhe certifikata perkatese e dhene nga nje organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose I huaj .

**2.3.10** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
----	--------------------	---------	-------

1	<i>Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
2	<i>Kamion vetëshkarkues kapacitet mbajtës min. 10 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
3	<i>Kamioncine 3 deri ne 5 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
4	<i>Kamioncine deri ne 1-3 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
5	<i>Kamion me Vinc me kapacitet mbajtës 5-10 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
6	<i>Trajler per transport mjetesh</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
7	<i>Rimorkio për transport mjetesh</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
8	<i>Fadrome me Goma</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
9	<i>Mini fadrome/</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Cope 1</i>
10	<i>Autobot uji</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
11	<i>Pomp penobetoni</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Cope 1</i>
12	<i>Autobetoniere</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
13	<i>Autopompe betoni</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
14	<i>Vibrator betoni</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
15	<i>Pompa Suvatimi</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
16	<i>Armatura druri (betoforma ) 50 m2</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>50 m2</i>
17	<i>Depozite uji 1000l-5000l</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Cope 1</i>
18	<i>Pompa Uji</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
19	<i>Pajisje niveluese per nivelim shtresash</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
20	<i>Gjenerator</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
21	<i>Elektrosaldatrice</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
22	<i>Fabrike Prodhimi dyer dritare PVC dhe duralumin</i>	<i>Ne pronesi ose me qera ose me kontrate furnizimi</i>	<i>Cope 1</i>

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 57 copë
- Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 5 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 5 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 10 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë

Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të treguara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton pronësinë e mjetit: - certifikatën e pronësisë; - leja e qarkullimit; - certifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; certifikatën e transportit të mallrave; fotot përkatëse ku të duket qarta targa;
- Ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata noteriale e qirase, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve, shoqëruar me certifikatën e pronësisë; - leja e qarkullimit; - certifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; fotot përkatëse ku të duket qarta targa, certifikatën e transportit të mallrave për përdorim vetja dhe për të tretet;
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, fotot ku të duket qarta dhe shërbimi i tij, ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata noteriale e qirase, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes ndërsa kur janë të marra me qira duhet të paraqitet kontrata e qirasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

*Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".*

2.3.11 Operatori ekonomik për të siguruar shërbimin mjekësor në shoqëri duhet të ketë të punësuar **një mjek** të përgjithshëm ose të ketë të kontraktuar nga jashtë këtë shërbim.

Në rastin kur mjeku është i punësuar në shoqëri, duhet të paraqesë një kontratë pune të vlefshme, licensë për ushtrimin individual të profesionit, diplomë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën **maj- korrik 2022**

Në rastin kur mjeku është kontraktuar nga jashtë, do të paraqitet kontrata për këtë shërbim, licensa përkatëse, si dhe faturen e këtij shërbimi, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë" ndryshuar me vendimin nr. 632, datë 15.7.2015).

### **2.3.12.Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

*a-Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë :*

- ISO 9001:2015    *Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë*
- OHSAS 18001-2007 ose ISO 45001-2018    *Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë*

*Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë në perputhje me perqindjen .*

**Shënim:** Për pikat 2.3.4 - 2.3.11 si më sipër, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin:

Formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.8.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Autoriteti Kontraktor do të bejë verifikimin e dokumentacionit në perputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të paraqesi dokumentacionin provues, original ose të noterizuar sipas deklaratës së mësipërme përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, , brenda afatit nga dërgimi i njoftimi për paraqitjen e tyre.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

**Shtojca 8.**

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I. Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik  
 \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK**

<b>Identifikimi</b>	<b>Përgjigja</b>
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Punët/ pajisjet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet, mbi kapacitetin e, të cilave do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

## **Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**

### **A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]

statusin aktiv.	Lloji i dokumentacit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:  Adresën e ueb-it: [shkruajeni]  Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]  Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/> <hr/> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p>	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:  Adresën e ueb-it: [shkruajeni]  Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]  Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:  Adresën e ueb-it: [shkruajeni]  Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]  Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:  Adresën e ueb-it: [shkruajeni]  Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]  Lloji i dokumentit: [shkruajeni]



<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

#### **B: DEKLARATA Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura**

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:	
1. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklarate;	Po [ ]
2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;	Po [ ]
3. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit;	Po [ ]
4. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit;	Po [ ]
5. Për efekt të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që:  a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti/Enti Kontraktor;  b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës .	Po [ ]
6. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër;	Po [ ] Jo [ ]
7. Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).	Po [ ] Jo [ ]

<p>8. Në veçanti, pa cenuar pikat 6 dhe 7 më lart, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, kontratë ose marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me :</p> <p>a) çmimet;</p> <p>b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;</p> <p>c) qëllimin ose vendimin për të paraqitur një ofertë ose jo; ose</p> <p>d) paraqitjen e një oferte që nuk plotëson specifikimet e kërkesës së ofertës.</p>	<p>Po [ ] Jo [ ]</p>
<p>9. Për më tepër, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, marrëveshje ose kontratë me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet ose kërkesat specifike të punëve shërbimeve/apo pajisjeve në lidhje me prokurimin përkatës, përveç kur thuhet në pikën 7 më lart.</p>	<p>Po [ ] Jo [ ]</p>
<p>10. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të ditura ose treguar ofertuesve të tjerë në asnjë mënyrë, qoftë para datës dhe orës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes së ofertës fituese dhe nënshkrimit të kontratës, përveç nëse kërkohet nga ligji ose nëse thuhet specifikisht nën pikën 7 më lart.</p>	<p>Po [ ] Jo [ ]</p>

### C: DEKLARATA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

<p><b>Deklarata</b></p>
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:</p> <p>Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.</p>
